

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"ERAL» SH. P. K.

EMERTIMI-OBJEKTI-QENDRA-KOHEZGJATJA

NENI 1 – Emertimi i shoqerise

Shtetasi shqiptar:

FAKO MEMINI, i biri i Lutos dhe i Hasifese, lindur ne Mertiraj (Vlore) me 05.01.1950 dhe banues ne Vlore ne lagjen "24 maji", rruga e Parkut te Industrise; eshte ortak i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e quajtur "*ERAL*" shpk.

Shoqeria eshte person juridik dhe ushtron veprimtarine ne baze te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 «Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare».

NENI 2 – Objekti i veprimtarise se shoqerise

Objekti i veprimtarise se shoqerise do jete si vijon:

Sigurimin e objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personale fizike e juridike qe ushtrojne veprimatri ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe sigurimin e mbrojtjen e jetes e te shendetit te personale fizike, shtetas shqiptar ose te huaj.

NENI 3 – Kohezgjatja e veprimtarise

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin tregtar do jete subjekt i te drejtes shqiptare deri me 31.12.2025.

Me vendim te ortakut te vetem afati i mesiperm mund te zgjatet ose shoqeria mund te shkrihet me pare.

NENI 4 – Selia e shoqerise

Shoqeria "*ERAL*" Shpk ka qendren ne Vlore ne adresen: lagje "28 Nentori", Rajoni Nr.5 dhe do te kete te drejte te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

Shoqeria mund te krijojë agjensi, zyra perfaqësimi, qendra dytësore ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

NENI 5 - Kapitali i regjistruar

Kapitali i shoqerise eshte LEKE 4.000.000 (kater milione) dhe eshte teresisht kapital financiar i ortakut te vetem.

Kapitali eshte i ndare ne 100 kuota me vlere 40.000 (dyzetmije) leke secila.

Kapitali i shoqerise mund te rritet apo zvogelohet me vendim te ortakut te vetem.

NENI 6 – Trasferimi i kuotave

Kuotat e kapitalit jane lirisht te transferueshme me vendim te ortakut te vetem ose ne rruge trashegimie.

NENI 7 – Ortaku i vetem

Shoqëria zotërohet nga një ortak dhe të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortakut i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortakut i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investimet e reja;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria

NENI 8 – Drejtimi dhe administrimi


8.1. Shoqëria tregtare "ERAL" shpk do drejtohet nga nje administrator qe emerohet me vendim te ortakut te vetem.

Administrator i Shoqerise per periudhen 5 vjeçare duke filluar nga data e sotme deri me 23.05.2016 do jete ortakut i vetem FAKO MEMINI.

8.2. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga ortakut i vetëm;
- b) përfaqëson shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut te vetem për miratim;
- d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përpara ortakut te vetem në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;





8.3. Ortaku i vetem mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

8.4. Administratori mund të ushtroje të gjitha kompetencat që nenit 81 të ligjit 9901 date 14.04.2008 nuk i rezervohen ortakut të vetem.

Administratori mund të delegoje kompetencat e tij duke emeruar perfaqesues dhe duke percaktuar tagrat e perfaqesimit në aktin e delegimit, por nuk mund të delegoje pergjegjesite e tij ligjore.

8.5. Administratori do shperblehet sipas percaktimit të ortakut të vetem në përputhje me parashikimin e nenit 97 të ligjit nr.9901 date 14.04.2008.

NENI 9 – Kontrolli i brendshem

Shoqëria tregtare organizon kontrollin e brendshem me një ekspert kontabel të autorizuar, i cili është pergjegjes përpara kesaj shoqërie për demet që mund të shkaktoje nga moskryerja në rregull e detyres së tij.

NENI 10 – Bilanci dhe të ardhurat

Veprimet ekonomike e financiare të shoqërisë mbyllet me 31 dhjetor të çdo viti përveç rasteve të urdherave të vecanta të ortakut të vetem të saj. Në fund të çdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabel me rezultatin ekonomik HUMBJE FITIME.

Bilanci kontabel miratohet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe pas përfundimit të detyrimeve fiskale pjesa që mbetet i jepet për përdorim Ortakut të vetem të saj.

NENI 11 – Shperberja e shoqërisë

Shperberja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak. Në rast shkrirje për afatit të shoqërisë, Ortaku i vetem vendos mbi menyrat e likuidimit dhe cakton një ose më shumë likuidatore duke iu percaktuar edhe detyrat.


Në rastin e likuidimit emertimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shenimi: SHOQËRI NE LIKUIDIM E SIPER.

Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

NENI 12 – Dispozita perfundimtare

Për sa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut do i referohet plotësisht te bera nga ORTAKU I VETEM.





Shoqëria "ERAL" SHPK do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare dhe do ushtroje
aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislativës shqiptare në përgjithësi,
normat e këtij statuti dhe aktit themelues bashkëngjitur.
Ky statut nënshkruhet prej ortakut në datë 24.05.2011.

ORTAKU I VETEM / Floro Meksi

Floro Meksi

Vlore, më njëzet e katër maj dymijë e njëmbëdhjetë



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE VLORE
NOTERE JETMIRA VERAJ

Vlore, me 24.05.2011

Repertori Nr.1256
Koleksioni Nr.670/3

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Vlore sot ne diten e njezet e kater te muajit maj viti dymije e njembdhjete, para meje Noteres JETMIRA VERAJ, e regjistruar ne Dhomen e Notereve Vlore, ne zyren time noteriale te ndodhur ne rrugen Vlore – Skele, Kryqezimi i Kalit te Trojes, Kulla Nr.3 te Parku "Rinia", u paraqit personalisht shtetasi shqiptar:

FAKO MEMINI, i biri i Lutos dhe i Hasifese, lindur ne Mertiraj (Vlore) me 05.01.1950 dhe banues ne Vlore ne lagjen "24 maji", rruga e Parkut te Industrise; me zotesi te plote per te vepruar, i njohur prej meje Noteres per identitetin e te cilit jam e bindur, pajisur me leternjofftimin N.024578242; paraqitur me cilesine e Ortakut te Vetem te shoqerise "ERAL" shpk me qender ne Vlore, regjistruar si person juridik ne date 10.03.2003 me NIPT K36510222R.

I paraqituri kerkoj prej meje Noterei vertetimin e nenshkrimit te tij ne vendimin e mesiperm dhe ndryshimin e statutit dhe ne statutin e ri te shoqerise bashkengjitur.

Une Noterja duke qene e bindur per identitetin e te paraqiturit dhe vullnetin e tij te lire, legalizoj nenshkrimin e tij.

NOTERE

JETMIRA VERAJ